



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 40, datë 23.05.2016

Për

**“THEMELIMIN DHE PJESËMARRJEN E BASHKISË SË TIRANËS NË
SHOQËRINË AKSIONARE “ECO TIRANA” SH.A., MIRATIMIN E AKTIT TË
THEMELIMIT DHE STATUTIT”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.4, pika 1/1.6 shkronja “b”, nenit 23, neni 26, nenit 33, pika 1 shkronja “d”, neni 54, shkronja “d” të Ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; neni 3, Pjesa V “Shoqëritë Aksionare” dhe neni 213, Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, për “Tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, ju paraqesim çështjen si më poshtë vijon:

V E N D O S I:

1. Të miratojë themelimin dhe pjesëmarrjen e Bashkisë së Tiranës në shoqërinë aksionare me ofertë private e quajtur “Eco Tirana” sh.a., me kapital të barabartë me 3.900.000 (tremilion e nëntëqind mijë) Lekë, me një vlerë nominale prej 1.000 (një mijë) Lekë secili, ose ekuivalenti në Euro sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e themelimit të saj.
2. Bashkia e Tiranës të zotërojë 1.989 (një mijë e nëntëqindetëdhjetëenëntë) aksione, të cilat përbëjnë 51% (pesëdhjetë e një për qind) të kapitalit themeltar të “Eco Tirana” sh.a., me një vlerë prej 1.989.000 (një milion e nëntëqindetëdhjetëenëntë mijë) Lekë ose ekuivalentin në Euro sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e themelimit të saj.
3. Të miratojë Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë “Eco Tirana” sh.a. bashkëlidhur këtij vendimi si Shtojca nr. 1.
4. Për një periudhë fillestare, jo më të gjatë se 18 (tetëmbëdhjetë) muaj, “Eco Tirana” sh.a. do të mbulojë shërbimin e mbledhjes dhe largimit të mbetjeve urbane për atë pjesë të territorit të Bashkisë së Tiranës të identifikuar në Shtojcën nr. 2 si “Zona e Kuqe”. Vlera vjetore e kontratës së shërbimit për Zonën e Kuqe do të jetë jo më pak se 2.500.000,00 (dy milion e pesëqindmijë) Euro pa TVSH – e barbartë me 330.000.000 (treqindetridhjet milion) Lekë pa TVSH ose ekuivalentin sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e nënshkrimit -, e shtuar me një vlerë të barabartë me 10% (dhjetë për qind) sapo “Eco Tirana” sh.a. fillon mbledhjen e diferencuar të mbetjeve. Në përfundim të muajit të 18 (tetëmbëdhjetë), në mungesë të ankesave objektive dhe të dokumentuara mbi mbarëvajtjen e shërbimit, administrimi i mbledhjes së mbeturinave urbane do të zgjerohet automatikisht dhe gradualisht në të gjithë Bashkinë e Tiranës. Shërbimi i ofruar nga “Eco Tirana” Sh.A. për Bashkinë e Tiranës do të ketë një kohëzgjatje jo më të vogël se 25 (njëzetepesë) vjet.

5. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij të përfaqësojë Bashkinë e Tiranës për kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për themelimin e shoqërisë “Eco Tirana” sh.a. sipas përcaktimeve të pikës 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi dhe lidhjen e marrëveshjes midis ortakëve.
6. Ngarkohet për zbatimin këtij vendimi Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar.
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI